



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:087831  
Datë: 22.03.2024  
Numri i dokumentit: 05491072

**P.nr. 38/23**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË**- Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe bashkëpunëtoren profesionale Hajrije Krasniqi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B. Z., për shkak të veprës Vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/II.nr.1769/22 të dt. 04.04.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt.21.03.2024, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Venera Shala, si dhe i akuzuari B. Z. me dt.22.03.2024, shpallë, dhe e përpilon këtë:

## A K T G J Y K I M

**I AKUZUARI: B. Z.** nga i ati H. dhe e ëma H. e lindjes S., i lindur me dt....., në fshatin T., Komuna e Malishevës, me banim në D., Rr. "Sh. Z." nr....., me nr. personal ....., shqiptar, shtetas i R të Kosovës, i martuar, i ati i 3 (tre) fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, punëtor në sektorin privat, i gjendjes së dobët ekonomike.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Me datën 24.10.2022, në fshatin T., Komuna e Malishevës, në vendin e quajtur "Rrezja e Balishtes", saktësisht në parcelën me numër P-..., pronë e të dëmtuarit Sh.B., i pandehuri B. Z., me qëllim të vjedhjes, me motor sharrë dhe sëpatë, i prenë 28 trungje drunjësh të llojit "bung dhe qarr", me diametër të ndryshëm, e në gjatësi mesatare prej 6 m, në sasi të përgjithshme prej 2.06 m<sup>3</sup>, drutë i ngarkon në traktorin e tij dhe nga aty largohet në drejtim të panjohur, me të cilat veprime të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material.

- me këto veprime ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 349 pra.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4,7,17, 38, 39, 40, 43 dhe 69 të KPRK-së (Kodit nr. 06/L-074) si dhe nenit 365, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të njëjtit ia shqipton:

## DËNIMIN ME GJOBË

Ashtu që e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej 200 € (dyqind ) euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në xhirollogarinë e kësaj gjykate në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgu, në kohëzgjatje prej 10 ditësh, duke llogaritur çdo ditë burgu nga 20 euro.

I dëmtuari Sh. B. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

Obligohet i akuzuarit në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t`ia paguajnë shumën prej 30 euro, ndërsa 20 € për programin për kompensimin e viktimave të krimit, ndërsa shpenzime të procedurës penale nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të bëhet me detyrim.

## A r s y e t i m

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1769/22 të dt. 04.04.2023, e ka akuzuar B. Z., për shkak të veprës penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarin t`a shpall fajtor dhe t`a dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 21.03.2024, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit Venera Shala, si dhe i akuzuari B. Z., andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari B. Z., në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se me vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, mirëpo unë nuk e kam ditur saktësisht që ajo tokë nuk është e imja, unë kam qenë në familje dhe i kam kërkuar falje për këtë rast, ky ka qenë rasti im i parë që kam ra ndesh me ligjin andaj kërkoj nga gjykata që të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të më shqiptohet një dënim sa më i butë, i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm që të mos kryej kurrfarë vepre penale.

Prokurori i shtetit Venera Shala në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari pasi që ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion duke i ditur pasojat dhe benifitet e një

pranimi i tillë, si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit propozoj gjykatës që të ketë parasysh pranimin e fajësisë, pendimin për veprën penale të kryer, kërkim faljen, ndërsa si rrethana rënduese gjykata duhet ti ketë parasysh faktin se i dëmtuari është viktimë e ndjeshme si dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

## 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

- se i akuzuari B.Z.me dashje ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 349 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Raporti fillestar i incidentit, me nr. ... i datës 31.10.2022;
- Raporti i policit S. H., ID# ..., me nr. ... i datës 31.10.2022;
- Raporti i policit S. M., ID# ..., me nr. të rastit ...;
- Raporti i policit B. P., ID# ..., me nr. ... i datës 26.10.2022;
- Raporti i vlerësimit të dëmit i përpiluar nga Drejtoria për Buqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i Komunës së Malishevës, i datës 02.11.2022;
- Certifikata e pronësisë e lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Malishevës e datës 24.05.2022;
- Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i përpiluar nga Njësia Forenzike me nr....;
- Deklarata e përfaqësuesit ligjor (prindit) të dëmtuarit, A. Z. dhënë në polici me datë 23.12.2023;
- Deklarata e të pandehurit B. Z., dhënë në polici me datë 28.10.2022;
  
- Deklarata e të dëmtuarit Sh. B., B.Z.dhënë në polici me datë 25.10.2022;
- Fotografite si dhe shkresat tjera në lëndë.

#### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 349 par.1 është paraparë se „ *Kushdo që me qëllim të vjedhjes pret trungjet në pyll dhe sasia e druve të prerë tejkalon 2 metra kub, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit*”.

#### 5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin B. Z. e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitivin e aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

#### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-së ashtu që gjykata me rastin e caktimit të dënimit pati parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajit nga ana e të pandehurit, i njëjti është penduar dhe i ka kërkuar falje të dëmtuarit, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, është mbajtës i familjes prej nëntë (9) anëtarësh, për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, nuk është recidivist, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata mori parasysh peshën e veprës penale, rrezikimin e të mirës materiale, dhe për këtë gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarit mund të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 7. Vendimi mbi udhëzimin në kontestin civil

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin civil është marr konform nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

#### 8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 paragraf 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr. 38/23, me dt. 22.03.2024.**

Bashkëpunëtorja profesionale  
**Hajrije Krasniqi**

Gjyqtari i vetëm gjykues  
**Lulzim Paçarizi**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.